



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.182

dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.909, datë 29.12.2007	Për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe energjisë elektrike të ndërmarrjeve publike	5669
Vendim i KM nr.912, datë 19.12.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Grekan të qarkut të Elbasanit	5675
Vendim i KM nr.914, datë 29.12.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.808, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”	5676
Vendim i KM nr.917, datë 29.12.2007	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash	5676
Vendim i KKRT nr.657, datë 18.12.2007	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV SKY”	5681
Vendim i KKRT nr.658, datë 18.12.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”	5681
Vendim i KKRT nr.660, datë 18.12.2007	Për heqjen e licencës së “TV Johaniter”	5682
Vendim i KKRT nr.662, datë 18.12.2007	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat “TV përsëritës Rai”	5685
Vendim i KKRT nr.663, datë 18.12.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Emanuel”	5685

VENDIM
Nr.909, datë 29.12.2007

PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE ENERGJISË ELEKTRIKE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të aktit normativ nr.2, datë 19.12.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Financave, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shlyerjen e detyrimeve të ndërmarrjeve publike në shumën 1 307 000 000 (një miliard e treqind e shtatë milionë) lekë për:

- a) 863 667 000 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore;
- b) 443 333 000 lekë për energjinë elektrike.

2. Shuma prej 1 307 000 000 lekësh t’u ndahet ministrive të mëposhtme:

a) Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 858 237 000 (tetëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh për:

- i) shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore 414 904 000 lekë;
- ii) shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH sh.a., 443 333 000 lekë, përkatësisht sipas lidhjeve nr.2 e nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 65 982 642 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) lekësh për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore të drejtorive të ujërave (bordet e kullimit), sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 382 780 358 (treqind e tetëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të sigurimeve shoqërore të ndërmarrjeve publike, sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Fondi prej 1 307 000 000 lekësh të përballohet nga fondi i kontingjencës, i planifikuar për vitin 2007.

4. Ngarkohen ministrinë e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi të realizojnë, brenda datës 31 dhjetor 2007, transferimin e fondeve përkatësisht në llogarinë e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe në llogarinë e KESH sh.a., si dhe të realizojnë kontabilizimin e tyre me institucionet e varësisë.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

Nr	Institucionet	Detyrime ndaj SSH-sh.a	Detyrime ndaj KESH-sh.a.	ne leke	
				Totali i detyrimeve	
1	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	414.904.000	443.333.000	858.237.000	
2	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatoreve	65.982.642		65.982.642	
3	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	382.780.358		382.780.358	
	Totali	863.667.000	443.333.000	1.307.000.000	

LIDHJA NR.2

DETYRIMET E NDERMARRJEVE TE UJESJELLESAVE NDAJ I.S.SH.-se

ne leke

Nr	Emertimi i subjektit	Shuma e detyrimit
1	Nd. e Ujesjellesit Fshat - Tirane	68.441.073
1	Ujesjellesi - Berat	27.899.000
2	Ujesjellesi - Kuçove	74.560.000
3	Ujesjellesi Poliçan - Skrapar	9.530.000
4	Sh.a. Ujesjelles - Mat	9.093.000
5	Ujesjellesi Patos - Fier	24.000.000
6	Ujesjellesi Fshat - Lushnje	18.595.000
7	Nd. Ujesjellesit - Tropoje	1.499.000
8	Nd.Uje Kanalizime - Shkoder	68.217.000
9	Nd. Ujesjellesit Fshat - Shkoder	5.326.000
10	Nd. Ujesjellesit - Malsi e Madhe	7.500.000
11	Nd.Uje Kanalizime - Kraste	552.000
12	Nd.Uje Kanalizime - Permet	1.413.000
13	Nd.Uje Kanalizime - Has	4.293.000
14	Nd.Uje Kanalizime - Pegin	1.274.000
15	Nd.Uje Kanalizime - Mirdite	3.614.000
16	Nd.Uje Kanalizime - Bulqize	7.916.000
17	Nd.Uje Kanalizime - Kruje	1.965.000
18	Nd.Uje Kanalizime - Puke	4.543.000
19	Nd.Uje Kanalizime - Gramsh	1.575.000
20	Nd.Uje Kanalizime - Kukes	1.394.000
21	Nd.Uje Kanalizime - Gjirokaster	9.559.000
22	Nd.Uje Kanalizime - Mallakaster	5.323.000
23	Nd.Uje Kanalizime - Kurbin	6.558.000
24	Nd.Uje Kanalizime - Korçe fshat	7.899.000
25	Nd.Uje Kanaliz. - Elbasan fshat	8.285.000
26	Nd.Uje Kanaliz. - Elbasan qytet	27.935.927
27	Nd.Uje Kanalizime - Fier	3.049.000
28	Nd.Ujesjellesit Gjirokaster fshat	3.096.000
	Shuma totale	414.904.000

LIDHJA NR.3

DETYRIMET E NDERMARRJEVE TE UJESJELLESAVE NDAJ KESH

ne leke

Nr.	Emertimi i Ndermarrjes	Viti 2007
		Janar-Shtator
2	Ndermarrja Ujesjelles Durrës	107.386,000
3	" " Kruje	61,000
4	" " Fushe Kruje	3.501,000
5	" " Kavaje	5.178,000
6	" " Rrogozhine	1.444,000
7	" " Lushnje Qytet	8.987,000
8	" " Fier	43.536,000
9	" " Patos	52.012,000
10	" " Ballsh	1.999,000
11	" " Vlore	39.380,000
12	" " Novosele	5.499,000
13	" " Novosele Fshat	3.107,000
14	" " Bilisht	1.554,000
15	" " Erseke	422,000
16	" " Pogradec	1.160,000
17	" " Gramsh	223,000
18	" " Librazhd	88,000
19	" " Peqin	2.077,000
20	" " Peqin Fshat	29.692,000
21	" " Berat	1.801,000
22	" " Ura-Vajgurore	3.073,000
23	" " Kucove	8.967,000
24	" " Skrapar	2.455,000
25	" " Polican	2.180,000
26	" " Lushnje Fshat	858,000
27	" " Divjake	457,000
28	" " Tropoje	4.349,000
29	" " Has	1.987,000
30	" " Kukes	6,000
31	" " Lezhe	14.993,000
32	" " Shkoder Qytet	38.642,000
33	" " Shkoder Fshat	4.708,000
34	" " Vau i Dejes	2.632,000
35	" " Bulqize	1.366,000
36	" " Krast	240,000
37	" " Lac	14.683,000
38	" " Diber	1.792,000
39	" " Mirdite	2.574,000
40	" " Gjirojastr Fshat	208,000
41	" " Gjirokaster Qytet	2.225,000
42	" " Libohove	1.095,000
43	" " Delvine	3.095,000
44	" " Permet	2.323,000
45	" " Sarande	8.698,000
46	" " Tepelene	5.577,000
47	" " Mat	5,000
48	" " Puke	52,000
49	" " Selenice	3.707,000
50	" " Kelcyre	1.279,000
TOTALI		443.333,000

LIDHJA NR.4**DETYRIMET E NDERMARRJEVE TE UJRAVE NDAJ I.S.SH.-se**
ne leke

Nr	Emertimi i subjektit	Shuma e detyrimit
1	Nd. e Ujrave (bordi kullimit) - Berat	19.105.000
2	Nd. e Ujrave (bordit kullimit) - Elbasan	10.765.675
3	d. e Ujrave (bordi kullimit) - Fier	1.714.000
4	d. e Ujrave (bordi kullimit) - Gjirokaster	6.000.548
5	d. e Ujrave (bordi kullimit) - Kavaje	2.853.000
6	d. e Ujrave (bordi kullimit) - Kukes	1.601.608
7	d. e Ujrave (bordi kullimit) -Lezhe	11.645.918
8	d. e Ujrave (bordi kullimit) - Mat	10.302.893
9	d. e Ujrave (bordi kullimit) -Pogradec	1.994.000
	Shuma totale	65.982.642

LIDHJA NR.5

DETYRIMET E NDERMARRJEVE PUBLIKE NDAJ I.S.SH.-se

ne leke

Nr	Emertimi i subjektit	Shuma e detyrimit
1	Baza e Riparimit te Avionave- Berat	10.647.587
2	Uzina Mekanike - Kuçove	23.470.864
3	Ndermarrja e Farerave- Berat	13.727
4	Ndermarrja e Shelgut- Berat	354.000
5	Ndermarrja e Kullotave- Berat	498.000
6	Ndermarrja Ushtarake- Berat	606.000
7	Ndermarrja Bujqesore Ushtarake- Berat	571.000
8	Enti Social Kulturor - Kuçove	2.449.971
9	Planteks- Durres	3.565.754
10	Pesticidet- Durres	2.845.000
11	Albkromi - Durres	1.924.191
12	Uzina Mekanike Bujqesore (U.M.B)-Durres	533.759
13	Qendra Informimit Ekonomik-Fier	105.000
14	Dega e Farerave -Fier	387.000
15	Klubi Sportiv-Tepelene	183.357
16	Enti Social Kulturor i Ushtrise -E.S.K.U - Tepelene	489.088
17	Ndermarrja Komunale -Tepelene	1.250.942
18	Ndermarrja Komunale -Memaliaj	243.619
19	Fabrika e Çorapeve- Korçe	34.467
20	NGP Drithi -Korçe	7.491.448
21	Uzina Instrumentave (U.I.K) - Korçe	7.641.496
22	Shtepia e Pushimit te Ushtarakeve-Pogradec	4.698.611
23	Miniera e Silikatit - Devoll	3.832.148
24	Shtepia e Pushimit Shengjin- Lezhe	715.233
25	Uzina e Superfosfatit - Laç	62.011.241
26	N.P.D Rreshen - Mirdite	1.172.703
27	Parku-Mirdite	92.654
28	Kantieri Nderim Miniera Rubik-Mirdite	461.927
29	Dega e Karburantit - Shkoder	1.251.860
30	Ndermarrja e Transportit Ujor Vau i Dejes-Shkoder	1.015.273
31	Parku i Udhetareve- Shkoder	427.206
32	Karburanti - Puke	561.000
33	Miell Buka - Puke	61.000
34	Uzina e Pjeseve te Nd. te Automjeteve - Tirane	28.018.156
35	Klubi Futbollit Partizani- Tirane	195.062
36	Tekstile te Pambukta-Tirane	387.646
37	ALGR-Cuk Sarande	1.848.952
38	Projekti i Menazhimit te Uitjes-Sarande	115.298
39	Kombinati Mekanik Poliçan - Skrapar	46.500.833
40	Stacioni i Zooteknise - Skrapar	1.312.000
41	Ndermarrja Punimeve Artistike- Durres	558.078
42	Ndermarrja e Cigareve - Durres	37.190.900
43	Ndermarrja Goma - Durres	16.755.053
44	Uzina e Koksit - Nd.Seleksionimit te Koksit-Elbasan	6.455.781
45	Kombinati Energjitik- Elbasan	34.793.238
46	Uzina Kimike -Gramsh	24.164
47	Fabrika e Kepuceve-Korçe	473.155
48	Stacioni i Bagetive te Imta - Korçe	7.917.697
49	Kombinati i Sheqerit - Korçe	26.911.738
50	Uzina Mekanike Bujqesore- Korçe	7.914.110
51	Ndermarrja e Trikotazhit- Korçe	1.360.686
52	Stacioni Eksperimental i Panxharit- Korçe	2.825.371
53	Ndermarrja e Imputeve-Dega e Farerave-Korçe	81.468
54	Shtepia e Ushtarakeve -Kukes	2.153.996
55	Filiali i Albturizmit - Kukes	930.729
56	Ndermarrja Komunale -Laç	1.659.609
57	Parku i Mallrave dhe Udhetareve - Vlore	6.878.370
58	Nd. Tregtare Shumices -Durres	2.762.458
59	Sh.a. Tekstili - Berat (pjesa shteterore)	5.148.684
	Totali i detyrimeve	382.780.358

VENDIM
Nr.912, datë 19.12.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GREKAN TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Grekan të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Grekan të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.9, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Grekan”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Grekan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Grekan		Lidhja 1
Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës.	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
5, 6	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
7-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
12-18	Shërbim funeral.	Në pronësi
19, 20	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
21-24	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje).	Në përdorim
26, 27, 34-40,44,53-79	Pyje kullota komunale.	Në pronësi
87-131	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuare).	Në pronësi
182-185	Furnizim me ujë të pijshëm.	Në pronësi
137,136,140,138,144-146,148,150,152,153,179	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive, kanale të treta).	Në pronësi
132-135, 139, 141-143, 147, 149, 151	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.914, datë 29.12.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.808, DATË 5.11.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E REZERVËS SË SIGURISË PËR
NAFTËN, GAZIN DHE NËNPRODUKTET E TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i parë i shkronjës “b” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.808, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sasia e rezervës së sigurisë, që do të depozitohet nga subjektet, të cilat kanë detyrimin për ta mbajtur këtë rezervë sigurie, është:

- i) jo më pak se 30 për qind në depozitat e vetë subjektit, të cilat janë të certifikuara teknikisht;
- ii) jo më shumë se 40 për qind në depozitat e certifikuara teknikisht të subjekteve, me të cilat subjekti, që ka detyrimin për të mbajtur rezervën e sigurisë, ka lidhur marrëveshje kontraktore.

Në rastin e marrëveshjeve kontraktore me subjektet e shitjes me pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për furnizim ekskluziv, sasia e rezervës së sigurisë do të llogaritet për jo më shumë se dy subjekte të tregtimit me pakicë.

Rezervë sigurie për subjektin llogariten edhe sasisë e kontraktuara e të likuiduara, por jo më shumë se 30 për qind e sasisë së rezervës së sigurisë së llogaritur, të vërtetuar me kontratat e nënshkruara dhe faturat përkatëse, për likuidimin e sasive të kërkuara.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.917, datë 29.12.2007

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objektet, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 296 577 544 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e

pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 697 000 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 296 577 544 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, pranë Bankës së Shqipërisë.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.1.2008 dhe të përfundojë më 15.2.2008.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Në proces regjistrimi” të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dokumentacionin e plotë të pronësisë.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe planimetrive përkatëse, që do t’i vihen në dispozicion nga zyra rajonale e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, në përfundim të procesit të regjistrimit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra rajonale e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE Të OBJEKTEVE Të CILAT PREKEN NGA NDëRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR RRëSHEN - KALIMASH**

NR.	PRONARI			VLERA LEKE	SHENIME
1	Aleksandër		Përleka	4005040	Proçes regjistrimi
2	Gjovalin		Përleka	2359400	Proçes regjistrimi
3	Nikoll	Gjok	Nikolli	2870713	Proçes regjistrimi
4	Fran	Nikoll	Prendi	1160789	Proçes regjistrimi
5	Frok	Nikoll	Prendi	1725400	Proçes regjistrimi
6	Preng	Nikoll	Prendi	2305430	Proçes regjistrimi
7	Ded	Preng	Prendi	2733544	Proçes regjistrimi
8	Gjergj	Ndue	Prenga	2980891	Proçes regjistrimi
9	Ndue	Pjetër	Prenga	3081266	Proçes regjistrimi
10	Mark		Marfana	2375022	Proçes regjistrimi
11	Gjetë	Kol	Kolaj	2025166	Proçes regjistrimi
12	Konstandin	Kol	Kolaj	2913239	Proçes regjistrimi
13	Dod	Kol	Kolaj	1676373	Proçes regjistrimi
14	Hil	Preng	Prenga (Ndoj)	2330284	Proçes regjistrimi
15	Ndrec	Ndue	Lleshi	2226206	Proçes regjistrimi
16	Pjetër	Ndue	Prenga	588217	Proçes regjistrimi
17	Martë		Prenga	1386707	Proçes regjistrimi
18	Viktor	Ndue	Prenga	1451977	Proçes regjistrimi
19	Shkurt	Preng	Ndoj	2967767	Proçes regjistrimi
20	Shkurt	Preng	Ndoj	643256	Proçes regjistrimi
21	Gjovalin	Zef	Skana	2781307	Proçes regjistrimi
22	Gjergj	Kol	Skana	3501995	Proçes regjistrimi
23	Tonin	Preng	Marku	2074754	Proçes regjistrimi
24	Aleksandër	Mark	Simoni	4718199	Proçes regjistrimi
25	Gjergj	Frrok	Marku	2399297	Proçes regjistrimi
26	Mark	Zef	Shyti	4300441	Proçes regjistrimi
27	Gjergj	Zef	Shyti	2482836	Proçes regjistrimi
28	Pjetër	Zef	Shyti	2863432	Proçes regjistrimi
29	Andon	Fran	Shyti(Zefi)	1311794	Proçes regjistrimi
30	Dedin	Preng	Koka	622472	Proçes regjistrimi
31	Nikoll	Ndue	Gjoka	4371625	Proçes regjistrimi
32	Mrica	Mark	Lleshi	1474687	Proçes regjistrimi
33	Simon	Pjetër	Lleshi	3437973	Proçes regjistrimi
34	Gjon	Ndue	Ndoj	6148943	Proçes regjistrimi
35	Mark	Preng	Gjoka	2294801	Proçes regjistrimi
36	Viktor	Fran	Pjetri	4554859	Proçes regjistrimi
37	Tonin	Dod	Nikolli	5768506	Proçes regjistrimi
	Nikoll	Dod	Nikolli		Proçes regjistrimi
	Gjetë	Dod	Nikolli		Proçes regjistrimi

38	Ndue	Mark	Laska	1414794	Proçes regjistrimi
39	Ndue	Mark	Gjoka	1086137	Proçes regjistrimi
40	Mirash	Ndue	Përshqefa	3689481	Proçes regjistrimi
41	Ndrec	Gjok	Marleka	1535857	Proçes regjistrimi
42	Pjetër	Dod	Shyti	3339444	Proçes regjistrimi
43	Zef	Nikoll	Nikolli	4022168	Proçes regjistrimi
44	Preng	Dod	Prenga	3339444	Proçes regjistrimi
45	Pjetër	Dod	Prenga	3269133	Proçes regjistrimi
46	Kin	Zef	Prenga	1725400	Proçes regjistrimi
47	Ndue	Preng	Gjoka	1956089	Proçes regjistrimi
48	Mark	Ndue	Gjoka	2053192	Proçes regjistrimi
49	Preng	Mark	Mena	2229647	Proçes regjistrimi
50	Gjin	Zef	Tuci	1980769	Proçes regjistrimi
51	Dod	Nikoll	Përshqefi	3607806	Proçes regjistrimi
52	Preng	Ndue	Deda	2135666	Proçes regjistrimi
53	Gjon	Ndue	Deda	2865447	Proçes regjistrimi
54	Ferdinand		Deda	3247467	Proçes regjistrimi
55	Zef	Mark	Vokrri	507319	Proçes regjistrimi
56	Frrok	Ndue	Vokrri	3075002	Proçes regjistrimi
57	Ndue	Llesh	Lleshi	2591388	Proçes regjistrimi
58	Martin	Ndue	Gjeta	689720	Proçes regjistrimi
59	Mark	Gjon	Ndreca	6950239	Proçes regjistrimi
60	Bibe	Ndue	Gjaci	2734260	Proçes regjistrimi
61	Ndue	Preng	Nikolli	3030569	Proçes regjistrimi
62	Zef	Ndue	Biba	2781599	Proçes regjistrimi
63	Kol	Ndue	Biba	1661690	Proçes regjistrimi
64	Ndue	Gjon	Lleshi	1653820	Proçes regjistrimi
65	Gjon	Mark	Lleshi	1182385	Proçes regjistrimi
66	Fran	Ndue	Lleshi	1700000	Proçes regjistrimi
67	Ndue	Zef	Lleshi	2483565	Proçes regjistrimi
68	Ndue	Varf	Loka	1365039	Proçes regjistrimi
69	Anton	Frrok	Vokrri	1874042	Proçes regjistrimi
70	Ndue	Zef	Pepa	2221526	Proçes regjistrimi
71	Gjon	Zef	Pjetri	3123385	Proçes regjistrimi
72	Gjin	Gegë	Pjetri	2821343	Proçes regjistrimi
73	Simon	Kol	Kolaj	5900946	Proçes regjistrimi
74	Gjetë	Llesh	Prenga	2209718	Proçes regjistrimi
	Gjon	Llesh	Ndreca	8472844	Proçes regjistrimi
75	Marie	Frrok	Skana	6103768	Proçes regjistrimi
76	Dod	Llesh	Ndreca	7424730	Proçes regjistrimi
	Nikoll	Llesh	Ndreca		Proçes regjistrimi
	Gjok	Llesh	Ndreca		Proçes regjistrimi
77	Zek	Gjon	Markpepa	2753953	Proçes regjistrimi
78	Ded	Kol	Skana	1927083	Proçes regjistrimi
79	Pjetër	Nikoll	Lleshi	1810048	Proçes regjistrimi

	(Dedin) Gjon	Preng	Marku	3638330	Proçes regjistrimi
80	Martë	Preng	Vorfi	723429	Proçes regjistrimi
81	Bardhok	Pjetër	Pjetri	2423745	Proçes regjistrimi
82	Gjin	Nikoll	Nikolli	2646818	Proçes regjistrimi
83	Mirash	Ndue	Përshqefa	1076950	Proçes regjistrimi
84	Mëhill	Zef	Prenga (Ahengu)	915779	Proçes regjistrimi
85	Preng	Gjetë	Prenga (Marku)	2384960	Proçes regjistrimi
86	Nikoll	Llesh	Prenga	6481512	Proçes regjistrimi
87	Mark	Ndue	Nikolli	5792412	Proçes regjistrimi
	Bibe	Ndue	Nikolli	1538246	Proçes regjistrimi
88	(Gjin) Pashk	Zef	Tuci	985273	Proçes regjistrimi
	Pjetër	Ndue	Tuci	1090520	Proçes regjistrimi
	Zef	Pjetër	Tuci	1046564	Proçes regjistrimi
89	Gjetë	Mark	Tuci	2469192	Proçes regjistrimi
90	Frrok	Zef	Lleshi	2167304	Proçes regjistrimi
	Mark	Zef	Lleshi	547603	Proçes regjistrimi
91	Nik	Zef	Gjoka	5331540	Proçes regjistrimi
92	Pjetër	Zef	Boci	934582	Proçes regjistrimi
	Ndue	Nikoll	Marku	1981886	Proçes regjistrimi
	Leon	Ndue	Prenga	1484412	Proçes regjistrimi
93	Ndoc	Ded	Deda	2255898	Proçes regjistrimi
94	Ndue	Gjon	Ndreca	1793502	Proçes regjistrimi
95	Nikoll	Zef	Gjaci	5104705	Proçes regjistrimi
	Albert	Zef	Gjaci	1794047	Proçes regjistrimi
96	Mark	Ndue	Lleshi	2420494	Proçes regjistrimi
97	Viktor	Preng	Lleshi	142360	Proçes regjistrimi
98	Nikolin	Gjon	Nikolli	3548455	Proçes regjistrimi
99	Nikoll	Vokërr	Nikolli	1941987	Proçes regjistrimi
100	Gjet	Vokërr	Nikolli	2204452	Proçes regjistrimi
101	Preng	Pjetër	Prenga	4787209	Proçes regjistrimi
102	Gjetë	Kol	Marleka	998995	Proçes regjistrimi
103	Llesh	Gegë	Pjetri	493067	Proçes regjistrimi
104	Nikoll	Llesh	Pjetri	1968786	Proçes regjistrimi
		TOTALI		296577544	

VENDIM
Nr.657, datë 18.12.2007

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV SKY”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 33 pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.616, datë 1.10.2007 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë dhe të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV SKY”, pasi ka pasur mungesa në dokumentacionin e paraqitur për rinovim dhe subjekti nuk ka shfaqur ndonjë interes apo pretendim për plotësimin e tij.
2. Subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.658, datë 18.12.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ALDO 03”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio televizivë” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e subjektit radiofonik vendor privat “Radio Aldo 03”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.660, datë 18.12.2007

PËR HEQJEN E LICENCËS SË “TV JOHANITER”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	kryetare
Frano Kulli	zëvendëskryetar
Artan Zeneli	anëtar
Detar Hysi	anëtar
Alban Karapici	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar
Sami Neza	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për heqjen e licencës së subjektit televiziv “TV Johaniter”.

Bazë ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33, neni 34 pika 1 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimeve nr.604, datë 1.10.2007 dhe nr.576, datë 27.4.2007 të KKRT-së,

VËREN SE:

Mbështetur në vendimin nr.22, datë 23.10.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka licencuar televizionin privat vendor “TV Johaniter”, për një periudhë 5-vjeçare për të mbuluar me sinjal televiziv rrethin e Durrësit. Në përfundim të afatit të licencimit, me vendimin nr.408, datë 23.1.2006, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, krahas miratimit të ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës, vendosi të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar, në fushën e transmetimeve analogjike tokësore, licencën për televizionin privat vendor “TV Johaniter”.

Nëpërmjet shkresës së datës 30.4.2007, z.Maksim Reka ka parashtruar ankesën si më poshtë vijon:

“Jam pronar i TV privat Johaniter me 40% të aksioneve, i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, datë 23.9.1999, nr.22008. Në momentin e rinovimit të licencës në vitin 2005 unë nuk jam marrë me dokumentacionin për arsye të problemeve madhore shëndetësore me djalin, ku më shumë qëndroja jashtë vendit. Në dhjetor të vitit 2005 kam kontaktuar me telefon me zyrën e licencave dhe më ka sqaruar një femër, se nuk bëjmë ndihmë personash neve. Por në shkurt të vitit 2007, kur paraqitem në zyrën juridike dhe interesohem për dokumentet se thjesht më nevojiteshin për ambasadë, doli se rinovimi i licencës ishte me persona të tjerë, ku vetëm emri i Robert Xhaferri ishte në rregull. Juristi më sqaroi se kemi dërguar një shkresë, ku ju kemi njoftuar se ju kemi shkruar si televizion dhe se duhet të aplikoni nga e para. Si ka mundësi që KKRT-ja shkrin një televizion dhe nuk ka asnjë shkresë nga pronari që ai ka firmosur për këtë? Dhe kjo letër zyrtare nga interesimi im personal ka ardhur vetëm për këtë televizion. Si ka mundësi që znj.Mira, shefe e financës me sa kujtohem, çdo shkresë e dublonte dhe me telefon dhe dërgoja me faks që bëra pagesat dhe mora njoftimin? Kurse kjo shkresë kaq e rëndësishme për zyrën si p.sh. “TV Johaniter” në fjalë nuk mund t’i bëhet vendim i ri gjykate pa mbyllur tjetrin po me vendim gjykate. Për ekzistencën e dosjes punonjësja e zyrës juridike thotë që nuk ekziston për arsye se punonjësja e arkivës që ka qenë, ka ikur nga puna. Kërkoj nga ana e KKRT-së që problemi im të zgjidhet.

Lidhur me ankesën e mësipërme, KKRT-ja vëren se:

Në datën 8.11.2005 përfundonte afati i licencimit për një sërë subjektsh radiotelevizivë, ndër të cilët edhe për subjektin “TV Johaniter”. Me shkresën nr.581 prot., datë 7.7.2005 KKRT-ja kishte njoftuar zyrtarisht këtë subjekt, sikurse dhe të tjerët, lidhur me mbarimin e afatit të licencës, duke u bërë të ditur dhe kriteret që do të merreshin parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave për rinovimin e licencave. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të aplikimeve për rinovimin e licencave të subjekteve radiotelevizivë, rezultoi se disa subjekte kishin të njëjtin problem të përbashkët. Konkretisht, subjektet “TV Amantia”, “TV Johaniter”, “TV 4+” dhe “TV Kombi” nuk kishin respektuar nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, sipas të cilit “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm

për subjektin të cilit i është dhënë...”.

Në rastin e subjektit “TV Johaniter” nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit për licencim rezultoi se, në momentin e licencimit, aplikimi për “TV Johaniter” ishte bërë në emër të shoqërisë “Johaniter” sh.a., me vendim nr.22008, datë 23.9.1999, ndërkohë që aplikimi për rilicencim për “TV Johaniter” ishte kryer në emër të shoqërisë “Johaniter” sh.p.k. Pra siç shihet, gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës, nuk ishte respektuar neni 22 i ligjit nr.8410, sipas të cilit “Licenca e transmetimit është e patjerësueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë...”. Në rastin konkret, licenca për “TV Johaniter” i ishte dhënë shoqërisë “Johaniter” sh.a. dhe jo shoqërisë “Johaniter” sh.p.k. dhe sipas nenit 22 dhe 25 të ligjit të sipërcituar, të drejtën për të depozituar kërkesën për rilicencim duhet ta kishte shoqëria “Johaniter” sh.a. dhe jo shoqëria “Johaniter” sh.p.k.

Për sa më sipër, si dhe mbështetur dhe në arsye të tjera të parashtruara në vendim, KKRT-ja me vendimin nr.401, datë 30.11.2005, vendosi të mos rinovojë licencën e subjektit “TV Johaniter”.

Sipas pikës 2 të vendimit nr.401, datë 30.11.2005 të KKRT-së, “TV Johaniter” kishte të drejtë të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim dhe nëpërmjet shkresës së datës 8.12.2005 i është drejtuar Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit me kërkesën që “...krahas miratimit të ndryshimit të të dhënave që kanë ndodhur në kërkesën për marrjen e licencës, të rilencohemi në të njëjtën kohë për televizionin privat vendor “TV Johaniter”, me arsyetimin se:

“Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të veprimtarisë televizive dhe me qëllim që veprimtaria e shoqërisë të ishte ekskluzivisht vetëm për veprimtari televizive, shoqëria “Johaniter” sh.a. vendosi të shndërrohej në shoqërinë “Johaniter” sh.p.k.

Lidhur me këtë moment, shoqëria jonë duhet të kishte njoftuar KKRT-në në kohën e duhur, në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

Përsa i përket mosnjoftimit të këtij ndryshimi në KKRT, shoqëria “Johaniter” sh.p.k. kërkon të falur dhe në të njëjtën kohë angazhohet me seriozitetin maksimal, se në të ardhmen do të respektojë jo vetëm detyrimin ligjor për të depozituar pranë institucionit tuaj, brenda afateve kohore, çdo ndryshim të të dhënave që janë paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës, por në të njëjtën kohë do të jetë i rregullt në zbatimin e të gjitha dispozitave ligjore që parashikohen për veprimtarinë televizive.

Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije, gjithashtu, se objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Johaniter” sh.p.k., do të jetë ekskluzivisht vetëm për veprimtari televizive, mbështetur në vendimin nr.33927/1, datë 22.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu siç edhe e kërkojnë dispozitat detyruese të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

Përsa më sipër, KKRT-ja me vendimin nr.408, datë 23.1.2006, vendosi që krahas miratimit të ndryshimit të të dhënave, të rinovojë licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV Johaniter”.

Pas ankesës së z.Maksim Reka, KKRT-ja nëpërmjet shkresës nr.556 prot., datë 16.5.2007, iu drejtua Zyrës së Regjistrimit Tregtar me kërkesën për informacion për të sqaruar faktin nëse shoqëria “Johaniter” sh.a.-ja (krijuar me vendimin nr.22008, datë 23.9.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë), është shndërruar ose jo në shoqërinë “Johaniter” sh.p.k., (krijuar me vendimin nr.33927, datë 7.9.2005 të Gjykatës së Rrethit Tiranë).

Zyra e Regjistrimit Tregtar, nëpërmjet shkresës nr.2609/1 prot., datë 21.5.2007, sqaron se shoqëria “Johaniter” sh.a.-ja krijuar me vendimin nr.22008, datë 23.9.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe shoqëria “Johaniter” sh.p.k., krijuar me vendimin nr.33927, datë 7.9.2005 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, janë dy shoqëri të ndryshme.

KKRT-ja vëren se, shoqëria “Johaniter” sh.a., është regjistruar në formën e shoqërisë anonime me vendimin nr.22008, datë 23.9.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Shijak, Durrës, lagja “Populllore”, me aksionarë z.Robert Xhaferri, z.Maksim Reka dhe znj.Teuta Hysa, me drejtor të parë të përgjithshëm z.Robert Xhaferri; me objekt të veprimtarisë “Veprimtarinë radiotevizive, e cila përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër. Gjithashtu, import-eksportin dhe tregtimin e materialeve filmike të ndryshme dhe aksesoreve të tyre”. Ndërsa shoqëria “Johaniter” sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr.33927, datë 7.9.2005, ndryshuar me vendimet nr.33927/1, datë 22.11.2005 dhe nr.33927/2, datë 27.2.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me kohëzgjatje mbi 10 vjet, me seli në Shijak, Durrës, me kapital themeltar

100 000 lekë, me administrator z.Robert Xhaferi, me ortakë z.Robert Xhaferri, z.Arjan Xhaferri dhe znj.Evelina Reka, me objekt të veprimtarisë “Shërbim me televizion lokal privat”.

Për sa më sipër KKRT-ja, për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, (pasi shoqëria “Johaniter” sh.a. nuk rezulton të jetë shndërruar në shoqërinë “Johaniter” sh.p.k., sikurse është parashtruar në kërkesën e datës 8.12.2005), me vendimin nr.604, datë 1.10.2007 vendosi të heqë paraprakisht licencën për subjektin “TV Johaniter”.

Lidhur me vendimin nr.604, datë 1.10.2007, KKRT-ja vëren se subjekti është njoftuar me shkresën nr.979 prot., datë 15.10.2007, dhe se në mbështetje të pikës 2 të vendimit subjekti kishte të drejtë që brenda një afati prej 30 ditësh të parashtronte mendimin e tij lidhur me këtë vendim të KKRT-së.

Nëpërmjet shkresës së datës 26.10.2007, z.Maksim Reka ka parashtruar kërkesën “...që KKRT-ja ta shikojë dhe njëherë problemin tonë në mënyrë ligjore dhe njerëzore, para se të marrë vendim përfundimtar lidhur me “TV Johaniter...”.

KKRT-ja vëren, gjithashtu se, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, sipas të cilit të drejtën (kompetencën) për të përfaqësuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me të tretët e ka administratori i shoqërisë, të drejtën për të përfaqësuar shoqërinë “Johaniter” sh.p.k., e ka z.Robert Xhaferri në cilësinë e administratorit të kësaj shoqërie.

KKRT-ja konstaton se deri më tani, nga ana e përfaqësuesit ligjor të subjektit “TV Johaniter” nuk është depozituar asnjë pretendim lidhur me vendimin nr.604, datë 1.10.2007 të KKRT-së.

Gjithashtu, KKRT-ja vëren se deri më tani subjekti “TV Johaniter” nuk ka shlyer pagesën vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet radiotelevizive për vitin 2006 në masën 91.5 mijë lekë dhe 36 mijë lekë, sipas vendimit nr.576, datë 27.4.2007 të KKRT-së.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 33, nenit 34, pika 1 dhe nenit 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën subjektit “TV Johaniter”.
2. Licenca me nr.007/TVL, e rinovuar me vendimin nr.408, datë 23.1.2006 të KKRT-së bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti “TV Johaniter” detyrohet të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.662, datë 18.12.2007

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT
“TV PËRSËRITËS RAI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 33, pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.576, datë 27.4.2007 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat me përsëritës “TV RAI”, pasi nuk ka shfaqur interes për rinovimin e licencës.
2. Subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.663, datë 18.12.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO EMANUEL”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio televizivë” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e subjektit radiofonik vendor privat “Radio Emanuel”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 14.1.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 14.1.2008
Doli nga shtypi më 15.1.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 20 lekë